



TERMA REFERENCE

THIRRJE PER TRAJNER / EKSPERT PËR AKTIVIZMIN QYTETAR

në kuadër të projektit:

“RRITJA E QËNDRUESHMËRISË SOCIALE DHE EKONOMIKE
TË GRUPEVE VULNERABËL TË PREKURA NGA TËRMETI
NË BASHKINË SHIJAK”

PËRMBAJTJA

INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

1.1 Autoriteti i kontraktuar

1.2 Rreth organizatës

1.3 Rreth projektit

2. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET SPECIFIKE

2.1 Objektivat dhe rezultatet e përgjithshme

2.2 Zona gjeografike

2.3 Puna specifike

3. MENAXHIMI I PROJEKTIT

3.1 Organi përgjegjës

3.2 Struktura e menaxhimit

4. LOGJISTIKA DHE KOHA

4.1 Vendodhja

4.2 Data e fillimit dhe periudha e zbatimit të detyrave

5. KERKESAT

5.1 Kriteret specifike për Trajnerin

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

1.1 Autoriteti i Kontraktuar

Shoqata “Together for Life” Rr. Brigada e VIII-të, Pallati Jeshil, Shk.2, Al. 14, Tirana, Albania.

1.2 Rreth organizatës

Shoqata “Together for Life” është një organizatë jofitimprurëse, e themeluar më 24 dhjetor 2009. Misioni i “Together for Life” është promovimi dhe mbroja e të drejtat e njerëzve në nevojë, të mbështesë familjet dhe komunitetet e marginalizuara me qëllim integrimin e tyre në jetën sociale. Programet e “Together for Life” fokusohen në fushën e shëndetësisë, barazisë gjinore, çështjet mjedisore, turizmit, transparencës dhe llogaridhënies. “Together for Life” kryen një sërë aktivitetesh që lidhen kryesisht me informimin dhe edukimin, fushatat publike sensibilizuese, investigime, kërkime dhe shkrimin e raporteve studimore.

1.3. Rreth projektit të Shoqatës “Together for Life”

Projekti që do të implementohet nga Shoqata “Together for Life” synon rritjen e qëndrueshmërisë sociale dhe ekonomike të grupeve vulnerabël të prekura nga tërmeti i nëntorit 2019 në Bashkinë Shijak nëpërmjet inkurajimit të aktivizmit qytetar, mekanizmave të angazhimit të komunitetit dhe transparencës së pushtetit vendor. Për të bërë të mundur realizimin e këtij qëllimi, projekti do të bashkëpunojë ngushtësisht me strukturat e Bashkisë për zbatimin e aktiviteteve të këtij projekti. Projekti do të kontribuojë në krijimin e mekanizmave vullnetare të komunikimit mes qeverisë vendore dhe komunitetit, me fokus tek grupet vulnerabël të prekura nga tërmeti në zonat urbane dhe rurale, ndërkohë që përmes këtyre mekanizmave do të bëjë të mundur jo vetëm komunikimin, por edhe përfshirjen e këtyre grupeve duke ofruar mundësi për pjesëmarrje në konsultime publike. Projekti do të krijojë dhe mbështesë mekanizmat e vullnetarizmit dhe aktivizmit komunitar duke rritur trasparencën dhe zërin e komunitetit për të adresuar në këtë mënyrë nevojat që ata kanë. Për të bërë të mundur artikullimin e nevojave urgjente që grupet vulnerabël kanë, si dhe për të identifikuar shërbimet e munguara dhe përmirësimin e shërbimeve ekzistuese do të shërbejnë pikat

e kontaktit që do të identifikohen, përzgjidhen dhe trajnohen nga projekti. Projekti do të punojë ngushtësisht me Bashkinë e qytetit të Shijakut për rëndësinë e transparencës me publikun.

Në vazhdimësi të sigurimit të transparencës, nga projekti do të do të ngrihet një platformë komunitare, në të cilën Bashkia Shijak do të publikojë vendimet e marra dhe të kërkojë mendim nga qytetarët e Shijakut, me qëllim që të adresojë në kohën e duhur nevojat dhe problematikat e tyre.

2. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET

2.1 Objektivat dhe rezultatet e përgjithshme te projektit

Objektivat e projektit janë si më poshtë:

1. Nxitja e aktivizmit qytetar dhe ngritja e mekanizmave të përfshirjes së komunitetit në përcaktimin e politikave dhe vendimmarrjes që pushteti vendor ndërmerr për rikuperimin dhe qëndrueshmërinë e familjeve vulnerabël dhe të prekura nga tërmeti.
2. Rritja e transparencës së pushtetit vendor në përgjigje të emergjencave civile përmes komunikimit të hapur dhe periodik me përfaqësues të komunitetit dhe grupeve të interesit.

Rezultatet e pritshme:

1. Identifikimi i aktivisteve nga komuniteti
2. Identifikimi i problematikave që shqetësojnë komunitetin në Shijak dhe përcaktimi i ndërhyrjeve për zgjidhjen e tyre
3. Realizimi i pesë nismave komunitare
4. Përfshirja e grupeve vulnerabël dhe të prekura nga tërmeti në përcaktimin e prioriteve që pushteti vendor ndërmerr për rikuperimin dhe qëndrueshmërinë e tyre.

2.2 Detyrat specifike të trajnerit

Trajneri do të jetë përgjegjës për:

1. Përgatitjen e një moduli trajnimi në formatin PPT, ose formate të tjera fokusuar në praktikën më të mirë të aktivizmit komunitar;

2. Rritja e njohurive dhe kapaciteteve te 20 aktivisteve te komunitetit dhe përfaqësues të bashkisë Shijak;
3. Nxitja e debateve / diskutimeve tek pjesëmarrësit nëpërmjet planifikimit dhe realizimit të seancave të diskutimeve, role-play, punë në grupe, në rëndësinë dhe rolin e aktivizimit të komunitetit në përmirësimin e politikave lokale;
4. Në bashkëpunim me stafin e projektit dhe trajnerët e tjerë do të konceptojë draft-agjendën e trajnimit;
5. Të realizojë seancën e trajnimit në përputhje me axhendën e aktivitetit, objektivat dhe rezultatet e dakorduara me stafin e projektit si dhe në përputhje me standardet dhe etikën profesionale.

Në afatet e vendosura nga stafi i projektit, por gjithmonë jo më vonë se 10 ditë nga realizimi i trajnimit, eksperti/ trajneri do të dorëzojë pranë stafit të projektit dokumentat e mëposhtme:

- a) Moduli i trajnimit (në word dhe më PPT) si dhe informacionet e tjera të përdorura gjatë trajnimit);
- b) Raport rreth impaktit të projektit tek pjesëmarrësit.

2.3 Angazhimi konkret sipas afateve kohore

Përshkrimi i aktivitetit	Vendi	Data/afatet	Ditë pune
Përgatitja e modulit të trajnimit	Zyrë / Tiranë	Janar 2022	3 ditë
Trajnimi		Janar 2022	2 ditë
Numri total i ditëve është			5 ditë

5. MENAXHIMI I PROJEKTIT

3.1. Organi përgjegjës

Shoqata “Together for Life” Rr. Brigada e VIII-të, Pll. Jeshil, Shk.2, Al. 14, Tirana, Albania

5.2. Struktura përgjegjëse

Projekti zbatohet nga Shoqata “Together for Life”. Kjo shoqatë është përgjegjëse për prokurimin dhe implementimin e çdo aktiviteti.

5.3. Lehtësirat nga Autoriteti Kontraktues

Autoriteti kontraktor do i japë kontraktuesit menjëherë çdo informacion dhe/ose dokumentacion të dobishëm që mund të jetë i rëndësishëm për zbatimin e kontratës.

6. LOGJISTIKA DHE KOHA

4.1. Vendndodhja

Bashkia Shijak.

4.2 Data e fillimit dhe periudha e zbatimit të detyrave

Koordinatori fillon angazhimin në kuadër të projektit në datën 19 janar 2022 dhe kontrata përfundon në datën 18 shkurt 2022.

7. KËRKESAT

5.1 Kriteret specifike për trainerit/es

Personat e interesuar për pozicionin e trajnerit/es duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- Të ketë diplomë në shkencat sociale, juridike ose të ngjashme me to;
- Të ketë eksperience të mëparshme në fushën e trajnimit me të rritur;
- Të ketë përvojë në punën në komunitetet dhe i/e përfshirë në aksione komunitare;
- Të ketë njohuri të mira gjuhësore në gjuhën shqipe;
- Të ketë komunikim shumë të mirë, të dëgjojë dhe respektojë mendimin e secilit prej personave të përfshirë në aktivitetet e projektit;
- Të ketë aftësi të mira pedagogjike të nxënimit interaktiv.

Kandidati duhet të paraqesë nëpërmjet emailit ose në zyrat e TFL (në adresat e mëposhtme):

- CV personale;
- Leter motivimi

Shoqata "Together for Life", Rr. Brigada e VIII-të, Pll. Jeshil, Shk.2, Al. 14, Tirana, Albania

Bashkia Shijak tek Receptioni (ne zarf te specifikohet titulli i projektit dhe marresi TFL)

Posta elektronike: info@togetherforlife.org.al

Afati përfundimtar per aplikim eshte data 14 Janar 2022, ora 17:00.

Aplikanti fitues do te njoftohet deri ne datën 17 janar 2022 dhe do te ftohet pranë zyrave te TFL per te nënshkruar kontratën ne datën 18 janar 2022.